



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06

**Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

**Vendosi:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 18 tetor 2021

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Urdhër në lidhje me Kërkesën e Prokurorisë për Zgjatje Afati**

---

**Prokurorit të Specializuar**  
Xhek Smith

**Mbrojtësit të Hashim Thaçit**  
Gregori Kihou

**Mbrojtësit të Viktimave**  
Sajmon Loz

**Mbrojtësit të Kadri Veselit**  
Ben Emerson

**Mbrojtësit të Rexhep Selimit**  
Dejvid Jang

**Mbrojtëses së Jakup Krasniqit**  
Venkatesvari Alagenda

**GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> në përputhje me nenin 39(13) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), dhe rregullat 9, 95(2)(b) dhe 102(3) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerr këtë urdhër.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 23 nëntor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi, ndër të tjera, që Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) të jepte një njoftim të hollësishëm të provave sipas rregullës 102(3) të Rregullores (“Njoftimi”) deri të premtën, 30 prill 2021.<sup>2</sup>
2. Më 24 mars 2021<sup>3</sup> dhe 24 qershor 2021,<sup>4</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake zgjati afatin e ZPS-së për dorëzimin e Njoftimit.
3. Më 31 korrik 2021, ZPS-ja dorëzoi Njoftimin.<sup>5</sup>
4. Më 8 dhe 14 shtator 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ndër të tjera urdhëroi ZPS-në që deri më 22 tetor 2021 të përgatiste një Njoftim të ndryshuar, me përshkrime më konkrete, ndryshoi më tej afatet lidhur me nxjerrjen e materialit të rregullës 102(3) dhe përsëriti se ZPS-ja duhet të nxjerrë ose lejojë qasje në materialin e zgjedhur, ose të parashtrojë kërkesë për masa mbrojtëse brenda tri javësh nga njoftimi/njoftimet e Mbrojtjes, si dhe të paraqesë kundërshtimet e veta në lidhje me rëndësinë materiale të

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-06, F00099, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me To*, (“Vendimi Kornizë”), 23 nëntor 2020, publik, para. 99(f).

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-06, Transkript i seancës, 24 mars 2021, publik, f. 390, rreshti 17 deri në f. 391, rreshti 10.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-06, F00370, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Zgjatje të Afatit për Dhënien e Njoftimit sipas Rregullës 102(3)*, 24 qershor 2020, publik.

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-06, F00421, Prokurori i Specializuar, *Njoftim i Prokurorisë sipas Rregullës 102(3)*, 30 korrik 2021, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale, dhe Shtojcën 2, rreptësisht konfidenciale dhe ex parte.

materialeve të rregullës 102(3) të kërkuara nga Mbrojtja, brenda dhjetë ditësh nga njoftimi/njoftimet e Mbrojtjes.<sup>6</sup>

5. Më 7 tetor 2021, Mbrojtja e Jakup Krasniqit kërkoi nxjerrjen e 5.945 materialeve të përmendura në Njoftimin (“Kërkesa e Krasniqit”).<sup>7</sup>

6. Më 14 tetor 2021, në lidhje me Kërkesën e Krasniqit, ZPS-ja i kërkoi Gjykatësit të Procedurës Paraprake të miratonte: (i) një zgjatje pesëjavore, përkatësisht deri më 23 nëntor 2021, të afatit për paraqitjen e kundërshtimeve mbi rëndësinë materiale dhe (ii) zgjatje të ngjashme dyjavore, përkatësisht deri më 7 dhjetor 2021, të afatit për nxjerrjen e materialit dhe/ose parashtrimin e kërkesave për masa mbrojtëse.<sup>8</sup> Gjithashtu, ZPS-ja i kërkon Gjykatësit të Procedurës Paraprake të ndryshojë afatet e zbatueshme për kërkesat e ardhshme sipas rregullës 102(3) me tri javë për paraqitjen e kundërshtimeve mbi rëndësinë materiale dhe me gjashtë javë për nxjerrjen e materialeve dhe/ose parashtrimin e kërkesave për masa mbrojtëse<sup>9</sup> (bashkërisht, “Kërkesat e ZPS-së”).

## II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

7. Në pajtim me rregullën 9(5)(a) të Rregullores, nëse i tregohen arsye të vlefshme, ose *proprio motu*, Paneli mund të zgjasë ose shkurtojë afatet e përcaktuara prej Rregullores ose prej Panelit.

8. Në bazë të rregullës 95(2)(b), Gjykatësi i Procedurës Paraprake përcakton afatet për nxjerrjen e provave.

---

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-06, F00460, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Ndryshim të Njoftimit sipas Rregullës 102(3)*, 8 shtator 2021, publik, para. 27; Transkript i seancës, 14 shtator 2021, publik, f. 625, rreshti 24 deri në f. 626, rreshtat 1-21.

<sup>7</sup> KSC-BC-2020-06, F00527, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Zgjatje Afati (“Kërkesa”)*, 14 tetor 2021, publik, para. 2.

<sup>8</sup> Kërkesa, para. 6(a).

<sup>9</sup> Kërkesa, para. 6(b).

9. Rregulla 102(3) e Rregullores përcakton se, në përputhje me nenin 21(6) të Ligjit, Prokurori i Specializuar i jep njoftim të hollësishëm Mbrojtjes për çdo material dhe provë që ka në zotërim. Materiale të tilla nxirren pa vonesë. Prokurori i Specializuar i drejtohet menjëherë Panelit në qoftë se ekzistojnë arsye për kundërshtimin e rëndësisë materiale të informacionit.

### III. DISKUTIM

10. Në lidhje me zgjatjen e kërkuar të afatit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se në të shkuarën ZPS-ja ka parashtruar kërkesa të ngjashme, të cilat janë miratuar.<sup>10</sup> Kërkesat e vazhdueshme të ZPS-së për zgjatjen e afateve lidhur me materialet e rregullës 102(3) nxjerrin në pah nevojën për një diskutim më i plotë mbi afatet ekzistuese për nxjerrjen e materialeve të rregullës 102(3). Pikërisht kjo pranohet edhe nga ZPS-ja në kërkesën konkrete për ndryshimin e afateve të zbatueshme për paraqitjen e kundërshtimeve mbi rëndësinë materiale të materialeve të rregullës 102(3) dhe për nxjerrjen e materialit dhe/ose parashtrimin e kërkesave për masa mbrojtëse për material të tillë.

11. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se konferenca e ardhshme mbi ecurinë e çështjes është dhe vendi më i mirë për një diskutim mes palëve dhe pjesëmarrësve për ndryshimin e afateve të ZPS-së lidhur me materialet e rregullës 102(3). Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson më tej se deri në momentin e mbajtjes së konferencës së ardhshme për ecurinë e çështjes, do të jetë më e qartë situata sa i takon sasisë së materialeve të rregullës 102(3) që ka kërkuar Mbrojtja. Si rrjedhojë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake shtyn deri në atë kohë marrjen e vendimit mbi Kërkesat e ZPS-së.

---

<sup>10</sup> KSC-BC-2020-06, F00487, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Zgjatje Afati*, 24 shtator 2021, publik; F00499, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Zgjatje Afati*, 30 shtator 2021, publik.

12. Deri në marrjen e vendimit mbi Kërkesat e ZPS-së, Gjykatësi i Procedurës Paraprake pezullon të gjitha afatet e ZPS-së lidhur me rishikimin e rëndësisë materiale dhe nxjerrjen e materialit të rregullës 102(3). Sidoqoftë, ky pezullim nuk ndryshon detyrimin e ZPS-së për parashtrimin e një Njoftimi të ndryshuar si dhe detyrimin e Mbrojtjes për të bërë me dije se në cilat materiale kërkon të ketë qasje qoftë me anë të këqyrjes ose nxjerrjes së tyre, sikurse është urdhëruar më herët. Në të njëjtën kohë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake inkurajon ZPS-në të punojë shpejt për nxjerrjen e materialit të rregullës 102(3) gjatë kësaj kohe derisa të merret një vendim mbi Kërkesat e ZPS-së.

13. Së fundi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u kërkon palëve dhe pjesëmarrësve që në parashtrimet e tyre për konferencën e ardhshme mbi ecurinë e çështjes të përfshijnë çdo pikë që duan të ngrenë në lidhje me Kërkesat e ZPS-së, sipas rastit.

#### IV. VENDIM

14. Për arsyet e përmendura më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a) **SHTYN** vendimin e tij mbi Kërkesat e ZPS-së deri në konferencën e ardhshme mbi ecurinë e çështjes;
- b) **PEZULLON** të gjitha afatet e ZPS-së lidhur me Kërkesën e Krasniqit si dhe afatet lidhur me rishikimin e rëndësisë materiale dhe nxjerrjen e materialeve në bazë të kërkesave të ardhshme të Mbrojtjes për materiale të rregullës 102(3), deri në kohën kur Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të nxjerrë vendimin mbi Kërkesat e ZPS-së; dhe
- c) **URDHËRON** Mbrojtjen dhe mbrojtësin e viktimave, nëse dëshirojnë, të parashtrojnë pikëpamjet e tyre në lidhje me Kërkesat e ZPS-së në parashtrimet përkatëse për konferencën e ardhshme mbi ecurinë e çështjes.

/nënshkrimi/

---

**Gjykatës Nikola Giju**  
**Gjykatësi i Procedurës Paraprake**

E hënë, 18 tetor 2021  
Në Hagë, Holandë